



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421205; Fax 033 421205 E-mail: info@bashkiavlore.org
Nr. 885 Prot. Vlorë me 03.02 2017

V E N D I M
Nr. 2, datë 31.01.2017

Per disa ndryshime ne VKB nr.44 date 28.12.2015 "Per miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave ne territorin e Bashkisë Vlore"

Këshilli i Bashkisë, ne mbledhjen e tij te datës 31.01.2017, pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Vlore, mbështetur ne ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, 54/f, ne ligjin nr.9632, date 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, neni 5/a, 21/3, si dhe ne ligjin nr.9920, date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar :

V E N D O S I:

- I. Te ndryshoje ne piken 1.a. "Tarifa për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi", pika 2 si me poshtë:
 - a. Niveli i tarifës 400 lek/m2/sezoni turistik, për plazhin e Nartës dhe Plazhin e Vjetër sipas shtojcës Nr. 1 "Lista e Plazheve", te VKM Nr. 369, dt. 18.05.2016
 - b. Niveli i tarifës 500 lek/m2/sezoni turistik, për te gjithë plazhet e tjerë ne territorin e Bashkisë Vlore, sipas shtojcës Nr. 1 "Lista e Plazheve", te VKM Nr. 369, dt. 18.05.2016

- II. Te riformulohet pika 3. "Tarifa e Shërbimit te Ndriçimit, pastrimit dhe Gjelbërimit", shkronja d "Për familjet", si me poshtë:

Përfshihen nga kjo tarife:

 1. Pensionistet
 2. Veteranet
 3. Invalidët e punës dhe te luftës
 4. Përfituesit e ndihmës ekonomike
 5. Te verbrit
 6. Te sëmure paraplegjike dhe tetraplegjike
 7. Te përndjekurit politike

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë zyrave të agjentit tatimor dëshminë e gjendjes së tyre dhe me konkretisht:

Te jenë kryefamiljare dhe pa persona të tjerë madhore, përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare.

Librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës, statusin e te verbrit, të sëmurëve paraplegjike e tetraplegjike, vërtetimin e të përndjekurit politik dhe vërtetimin nga Njësia Administrative për përfituesit të ndihmës ekonomike

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015.

KRYETARE


Vojsava SHKURTAJ



Ky vendim hyn në fuqi me shkresën nr. _____, date _____.2017 të Prefektit të Qarkut Vlorë